



KOMUNA E ISTOGUT

KUOTIMI I ÇMIMEVE

PROKURIMI ME VLERË MINIMALE

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e Ftesës: **20.2.2024**

Nr i Prokurimit	633-24-1271-1-4-7
Nr i brendshëm	633-024-005-147

NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KOMUNA E ISTOGUT	
Adresa e AK: Fadil Ferati, nr.121	
Qyteti: ISTOG	Kodi postar: 31000
Personi kontaktues: Gëzim Ademaj	Telefoni: 038 200 43 858
Email: gezim.ademaj@rks-gov.net	Faksi:

NENI II: IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

Emri i OE:	Personi kontaktues:
Adresa:	Telefoni:
Qyteti:	Faksi:
Kodi Postar:	E-mail:

NENI III: TË DHËNAT NË LISTEN E CMIMEVE

III.1) TITULLI I PROKURIMIT

FURNIZIMI DHE MONTIMI I KAMERAVE NE OBJEKTIN E KOMUNES (633-024-005-147)

III.1.1) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): **33451000-6**

III.2) Në mënyrë që të dëshmohet se Operatori Ekonomik (OE) është i përshtatshëm që të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, OE duhet të nënshkruaj dhe të paraqes me kuotimin e tij Deklaratën nën Betim të bashkangjitur.

III.3) PËRSHKRIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS

Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)	Cmimi Total - €
1	IP Kamera -1/2.9" CMOS, 2.8-12mm, F1.6, IR 80 m, 0.02Lux ,Up to 1920x1080@30fps, Built-in Mic, SD card slot, ONVIF (PROFILE S/T), SDK, Disk Full/Disk R/W Error/IP Address Conflict/Mask Alarm, No VCA, Metal+Plastic Housing, IP67	Cope	1		
2	VIGI IP PTZ Kamera 360 shkalle 4.0 MP full color	cope	2		
3	Poe extender 1X4 Port	Cope	2		
4	UTP Cat 6	Meter	200		
5	Cambox per kamera	Cope	3		
6	Zhvendosja e IP Kamera PTZ	Cope	1		
7	Instalimi dhe konfigurimi	Cope	4		
Totali i PËRGJITHSHËM me te gjitha ngarkesat:					

Nënshkrimi i zyrtarit te prokurimit të AK-së	Nënshkrimi i përfaqësuesit të OE-së
Emri dhe Mbiemri: Gëzim Ademaj	Emri dhe Mbiemri:
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Data:	Data:

Vula:	Vula:
-------	-------

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: _____ deklaroj nën betim se
unë jam i përshtatshëm sipas nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe
plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e
përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë me qëllim apo për shkak të
pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose
mashtroese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	

Kërkesat e Përshtatshmërisë
Sipas nenit 65 të LPP-04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin
Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

- 1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij:**
 - a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;
 - b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjesë të këtyre të fundit; ose
 - c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4 paragrafi 1.75.

- 2. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara:**
 - a. është dënua nga një gjykatë kompetente për veprën penale duke përfshirë praktikumin e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, shantazh ose aktivitetet e përshkruara ose të ngjashme me ato të përshkruara në nenin 130.1 të LPP-se nën ligjet dhe rregulloret në fuqi në Kosovë ose në cilindo vend, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;
 - b. është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rënde profesionale, e konstatuar nga një gjykatë kompetente;
 - c. është dënua nga një gjykatë kompetente për veprën penale të pjesëmarrjes në një organizatë kriminale, që përkufizohet si asociacion i strukturuar dhe i krijuar gjatë një periudhe kohore dhe që vepron në mënyrë të organizuar me qëllim të përfitimit financiar përmes veprimeve që konsiderohen si kriminale ose të kundërligjshme;
 - d. është dënua nga një gjykatë kompetente për veprën penale të mashtrimit ose të barabartë me mashtrimin;
 - e. është konstatuar nga një gjykatë kompetente, agjenci administrative ose organizatë për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se është sjellë në mënyrë joprofesionale; ose
 - f. është konstatuar nga ndonjë gjykatë kompetente se ka bërë keqëprezantim te ndonjë autoritet publik në Kosovë apo gjetiu.

- 3. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operatori ekonomik:**
 - a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent; apo aktualisht është objekt procedure (i) për deklarim të falimentimit, (ii) për një urdhër të mbylljes së dhunshme ose administrimi nga një gjykatë, apo (iii) për ndonjë procedurë të ngjashme sipas Ligjit të Kosovës apo ndonjë juridiksioni tjetër;
 - b. me vendim të një gjykate kompetente është likuiduar ose është vënë në mbikëqyrje të administratorit;
 - c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë për shkak se operatori ekonomik më parë ka qenë i paafet që të përmbushë obligimet e tij në afatin e duhur kohor;
 - d. është në një situatë të ngjashme me ato të përshkruara në nën-paragrafët a, b ose c të këtij paragrafi, që rrjedhin nga një procedurë e ngjashme sipas ligjeve në vendin ku është themeluar ose në vendin ku zhvillon veprimtarinë e tij afariste;
 - e. aktualisht i nënshtrohet një vendimi gjyqësor ose administrativ i cili suspendon pagesat nga operatori ose për atë operatori ekonomik dhe që rezultojnë në një humbje të tërësishme ose të pjesshme të të drejtave të operatorit ekonomik për të administruar ose disponuar me pasurinë e tij.
 - f. aktualisht është objekt i një vendimi gjyqësor ose procedure administrative që suspendon ose redukon pagesat nga operatori ekonomik ose për operatorin ekonomik; nëse procedurat e tilla gjithashtu mund të rezultojnë në vendimin për falimentimin ose likuidimin e operatorit ekonomik;
 - g. gjatë (3) tri viteve të fundit është konstatuar nga një gjykatë kompetente se nuk e ka përmbushur një kontratë me ndonjë entitet publik, autoritet publik ose ndërmarrje në Kosovë apo diku tjetër;
 - h. aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar te jete jo i rëndësishëm në Kosovë;
 - i. është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë me vonesë në pagimin e pagave të punonjësve ose në pagimin e obligimeve ndaj një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
 - j. ende nuk e ka zbatuar një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës;
 - k. ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes
; ose
 - l. nuk është shpallu fajtor me një vendim të plotfuqishëm të miratuar në përputhshmëri me Nenin 99.2 të LPP-se.